



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 26.12.2014, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Velimir Rakiq, Emilije Redzeqi, Murat Hoxha, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala.

Mungoi : Salih Salihu, Adem Salihaj, anëtarë nga PDK ende nuk është emëruar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit, i cili prezantoi veten dhe hapi punën e komisionit për këtë legjislacion.

Ai falënderoi ish Komisionin dhe kryetarin Nait Hasani dhe potencoi faktin se në atë legjislacion ky komision ka kryer mjaft punë voluminoze sa i përket sidomos miratimit të ligjeve në fushat e këtij komisioni, me rëndësi është, vazhdoi, që ky komision të jetë në punën e tij apartiak, në mënyrë që programet e partive politike të gjejnë zbatimin në ligjet që do të miratohen.

Në vazhdim u prezantuan **Velimir Rakiq, Haxhi Shala, Lahi Brahimaj, Murat Hoxha dhe Emilija Rexhepi** të cilët gjithashtu u deklaruan për bashkëpunim sa më të mirë dhe frymëzues. **Murat Hoxha** sugjeroi që dy ministritë që bëjnë pjesë në fushën e këtij komisioni të parashtrojnë planin e punës në mënyrë që pastaj komisioni të veproji, mirëpo zyrtari i fushës **Ylber Sherifi** sqaroi se përgatitja e planit të punës së Komisionit është i mvarur nga Strategjia legjislative e Qeverisë dhe plani i dokumenteve strategjike. Qeveria posa ti miratoje keto dokumente, komisioni do ti inkorporoj në planin e punës për vitin 2015, dhe rikujtoi se plani i punës së Komisionit për vitin 2014 është miratuar me 28 janar.

Duke pasur përvojën nga legjislatura e kaluar, edhe kryetari sugjeroi që së pari të pritët strategjia që do të arrij nga Qeveria, pastaj Komisioni do të kontribuoi në bazë të kompetencave legjislative që i ka. Në fund përshëndeti komisionin dhe uroj pushimet e fundvitit.

Mbledhja përfundoi në orën 13,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka